



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi dhe Përkthim

Ngarkesa në orë/kredite: 40 orë mësimore 4 kredite;; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri: Viti III /Semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me zgjedhje

Programi i studimit: Bachelor në “Përkthim dhe interpretim në gjuhën greke dhe angleze”

Kodi i etikës :Kodi i etikës i UT-së (nenet 4,6,7,9

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Pas përfundimit me sukses të këtij kursi studenti duhet të arrijë të marrë njohuritë bazë të Gjuhësisë së Përgjithshme, të njihet me konceptin e gjuhës humane, të dallojë atë nga mënyrat e tjera të komunikimit, të dallojë realitetin gjuhësor nga ai jashtëgjuhësor, të njohë shumëllojshmërinë gjuhësore, të njihet me karakteristikat kryesore të gjuhës, konceptet: sistem gjuhësor, shenjë gjuhësore, diakroni dhe sinkroni, relacion sintagmatik dhe paradigmatic. Gjithashtu, të analizojë çështjet që kanë të bëjnë me njësitë kuptimore dhe marrëdhëniet e tyre në çdo gjuhë, mënyrën sesi shprehet realiteti nga gjuha në gjuhë, të analizojë konceptin e njësisë përkthimore dhe rolin i saj në procesin përkthimor.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Studenti duhet të njohë teoritë bazë të analizës gjuhësore.
- 2.Të njohë mënyrën e funksionimit të gjuhëve në përgjithësi, dhe të gjuhës së punës në veçanti.
- 3.Të analizojë me mjetet e gjuhësisë së përgjithshme tekstet e ndryshme, përpara se t'i përkthejë.
- 4.Të dijë se si funksionon procesi i përkthimit si formë e komunikimit ndërgjuhësor, të njohë rëndësinë e diferencave gjuhësore, të ketë aftësi kritike, të përfitojë aftësi në trajtimin e vështirësive të përkthimit që vijnë si rrjedhojë e dallimeve ndërmjet gjuhëve.